

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E HËNË 31 TETOR 2022

Besoj se jemi në fund të një dite të gjatë diskutimi, por shqyrr që mbaroi! Besoj se ishte fundi i një kohe të shpenzuar kot, i një farse pa asnjë lloj kuptimi, me një fund të tillë të paralajmëruar, si ky që pamë, i cili nuk prodhon produkt në fund. Në vend që ta konsumonim debatin për disa çështje shumë të rënda e delikate, me të cilat Shqipëria përballet në çdo sekondë dhe minutë, dhe nga të cilat varfërohet në çdo minutë, e shpenzuar për këtë, por populli thotë: “Ani!”.

Meqenëse jemi këtu, le të themi disa gjëra të mëdha, të cilat shkojnë përtej fjalëve, përtej ndarjeve, përtej copave që duam të prodhojmë e të tjera. Fakt është se në vitin 2015 është bërë një reformë territoriale, e cila në teori vendosi disa objektiva dhe më kryesori ishte të shkurtonte njerëz, të kishte sa më pak personel që përpinte para. Shqiptarët duhet ta dinë që administrata lokale është dyfishuar, nuk është pakësuar. Në vend që të kursente disa miliona euro vit pas viti nga pagat, e ka mbushur deri në grykë me patronazhistë. A ka shërbime?! Dëgjova paturpësisht se ne vetëm gënjejmë për shërbimet e reja. Po çfarë të themi?! A mund t’i gënjejmë shqiptarët ne që një shërbim bazik, që bashkitë e kanë drejtuar prej vitesh, siç ishin ujësjellësit, arritën ta falimentonin, aq sa qeveria i rrëmbeu, duke i administruar vetë?! Pushtet lokal me këtë reformë, i cili po zhvillohej, po përparohej, po ofronte gjëra pozitive, çfarë bëri? Ra, sepse nuk administronte dot një ujësjellës. Bashkitë e tjera janë në falimentim financiar, por edhe atyre qeveria u ka caktuar administrator.

Çfarë kemi tani?! A kemi një pushtet lokal që ndrin?! Jo, kemi një pushtet lokal, i cili është rrëmbyer nga duart më të këqija të mundshme, i përkeqësuar në mënyrë katastrofike në qeverisjen koreane, njëpartiake, që lindi pas 2019-ës, që na sjell në këtë pikë, ku kemi bashki të falimentuara. Shumë qytetarë me gojën plot dhe me shumë të drejtë thonë: “Ishte më mirë kur ishte më keq!”. Çfarë bëri kjo reformë territoriale, këto bashki të mëdha? Këto kanë bërë vetëm një gjë “shumë pozitive”: ua kanë larguar shërbimet qytetarëve apo ua kanë hequr fare ato. Për qytetarët bashkia është një institucion që mbledh taksa dhe nuk u kthen asgjë mbrapsht; një institucion, të cilin e paguanin për të marrë shërbime, sot e paguanjë për patronazhistë. Thjesht ka lista të mëdha të mbushura me patronazhistë. Çfarë bashkie mund të jetë ajo, e cila nuk administron dot as ujësjellësin e saj, që ka një sistem pushteti lokal me dhjetëra e dhjetëra, 100 e kusur milionë euro shtesë vetëm për paga?!

Numri i punonjësve nga 17-18 mijë ka shkuar në 34 mijë Pra, është një ushtri parazitësh pa fund, që grabit para pa mbarim, me histori korruptive pa mbarim, që hyjnë e dalin në aferat e qeverisë pa cipë, siç është afera e inceneratorëve, ku bashkitë hyjnë e dalin nëpër to dhe në fund fare figurojnë borxhlinj. Si është gjendja e ujësjellës-kanalizimeve? Mizerabël! Përveç të tjerave, për shkak të këtij binomi qeveri – bashki, një ngjyrë, një kolor, i kombinimit koreano-verior, se, po të ishte koreano- jugor këtu do të flisnim ndryshe, kemi qindra e miliona euro borxh deri në grykë edhe për tenderime të kryera në mënyrë efektive pa para, të cilat u janë ngarkuar bashkive. Jemi në prag të falimentimit të tyre, pasi qeveria qendrore ngarkon qeverinë lokale, se të sajën e ka, duke i shkarkuar atje paratë e korrupsionit dhe duke e çuar atë poshtë e më poshtë. Sot nuk janë në gjendje të thonë se cili është shërbimi i ri pozitiv, i afërt, i ndryshuar me këtë reformë të madhe që ka ndodhur.

Ata dinë shumë mirë vetëm një gjë: i penalizuari kryesor në mënyrë të veçantë është fshati, që me të drejtë kishte pretendime të mëdha legjitime, që komunat duhej të ofronin shumë më shumë shërbime, por në disa raste u mungonin mjetet financiare dhe të gjitha këto qëndronin. Sot po i qajnë me lot komunat, se nuk kanë ku të trokasin, por u duhet të shkojnë deri në bashkinë e stërmadhe. Këta janë qytetarë të dorës së dytë, se janë në fshat dhe nuk kanë interes fare, por taksat ua kërkojnë atyre një për një, sikur janë në mes të qytetit si për pastrim, për gjelbërim e të tjera. Pra, do të gjelbërojnë fshatin, që është i gjelbëruar vetë, ndërkohë që po shkretojnë qytetet.

Sigurisht, ky pushtet lokal është pa fre, duke shtuar këtu edhe disa ndryshime shumë të rrezikshme që janë bërë, njërin prej të cilave e kemi paditur në Gjykatën Kushtetuese. Ky vendim kishte të bënte me llojin e votimit, që ishte me shumicë të cilësuar, për të marrë vendime të caktuara, që kishin të bënin me pronat dhe ngarkesën afatgjatë, por edhe ky vendim u votua me shumicë të thjeshtë, në mënyrë që të grabisnin më lehtë. Pra, çdo element i mirëkuptimit të gjerë, duke përfshirë edhe atë të komuniteteve, është zero. Ne e pamë historinë e inceneratorëve; e kemi parë në Fier në mënyrë të veçantë, por e kemi parë edhe në vende të tjera, ku komunitetet nuk pyeten fare. Pra, është thjesht dhe vetëm një pushtet lokal i specializuar, një gjymtyrë e korruptuar e qeverisë dhe asgjë më shumë.

Ju e keni parë që, edhe nëse një kryetar bashkie thotë diçka të vogël nëpër dhëmbë, e thotë sepse dëgjon histeritë e Kryeministrit, i cili ka dalë nga çdo kontroll, sepse nuk është në rregull nga trutë e kokës, sepse duhet që korrupsioni të rrjedhë, por në fund fare çfarë kanë fituar qytetarët?! Asgjë! Paguajnë taksa shumë të larta, siç i paguhen në mes të Tiranës, për ujin, për pastrimin, për arsimin, dhe sërish ka shkolla me turne, ujë me orar, ujë me bote, ndërkohë që premtimet kanë qenë të jashtëzakonshme: “Mbaroi historia e ujit. Në Tiranë ka 24 orë ujë!”. Ai mund të kenë paturpësinë ta

thotë përsëri më 14 maj që do të sjellë ujë 24 orë, por të gjithë janë të mençur dhe e dinë shumë mirë çfarë ndodh. Ndërkohë, miliona e miliarda lekë rrjedhin në kanale korruptive pambarim. Kjo ka sjellë krizën më të rëndë strukture institucionale ligjore dhe të shërbimeve që shqiptarët kanë parë ndonjëherë.

E përsëris edhe një herë: është dramatike, është e pabesueshme që shumë qytetarë, me të cilët kemi pasur mundësi të takohemi në të gjitha nivelet, por në mënyrë të veçantë të fshatit, po i qajnë komunitat e dikurshme, të cilat ne i anatemuam si struktura që ishin të paafta dhe të pazonja. Por korrupsioni, pushteti njëpartiak, rrëmbimi në një dorë të gjithave, i gjithë pushteti i sovjetëve me atë çmendurinë bolshevike të tyre, solli atë që qytetarët kanë humbur përfundimisht pushtetin lokal. Dëmi strukturor që i është bërë këtij pushteti, është kaq i madh, taksiratet financiare janë kaq të rënda, sa që ky pushtet do të kërkojë kohë, një vullnet shumë të fortë, një ndershmëri të jashtëzakonshme institucionale dhe një moral krejt të ri që të ketë mundësi të rimëkëmbet, sepse është tronditur financiarisht dhe strukturalisht, por, njëkohësisht, është tronditur thellë besimi qytetar.

Qytetarët e shikojnë bashkinë thjesht e vetëm si një tagërmbledhëse, si një bandë policës, që lufton me majdanozin e fshatarëve të varfër dhe me ndonjë tas me kastravecë e domate, të cilët janë të dhunshëm pafund, janë të heshtur dhe të çuditur përballë banditizmit, duke u qëndruar te koka se mos ndryshon ndonjëri dritaren, siç bëri Bojken Lako, apo ndonjë një tjetër që rregullon avllinë. Ndërkohë, kullat lartësohen në mes kryeqytetit, të cilat kanë zhdukur të gjithë memorien historike dhe kulturore të Tiranës në mënyrë të veçantë, por për ta nuk ka gjë, vetëm gdhihen një ditë dhe kujtohen se si u bë kjo kulla për 24 orë. Ky është një turp i jashtëzakonshëm. Këtu duhet të jetë i gjithë përqendrimi për ta denoncuar dhe për ta çuar deri në fund. Riprodhimi i njëjësive të tjera bashkiake të falimentuara si këto është një zhgënjim tjetër për qytetarët. Faleminderit!